



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2015/2016

TESTI GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

Të dëshirojmë sukses në punë!

1. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm dhe gjeje cili është dërguesi dhe cili është marrësi.

I dashur Ilir, mbaje veten!

Je gati? Po ta shkruaj këtë mesazh me kompjuterin tim të ri! Është e vërtetë! Ende nuk më besohet! Mamaja erdhi dje në shtëpi dhe më kërkoi ta ndihmoja të ngrinte bagazhet. Kundërshtova pak, por natyrisht shkova dhe e ndihmova. Kur ç'të shoh, një kompjuter fringo I ri brenda në një kuti. Është fantastike! Përse nuk vjen ta shohësh? Do të ishte shumë bukur të takoheshim. Si thua?

Të përqafoj fort!

Emi

a) Dërguesi _____;

b) Marrësi _____.

2. Trego se a ndryshon eseja nga shkrimi letrar?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

a) *nuk ndryshon*

b) *ndryshon*

c) *janë të ngjashëm.*

3. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe trego se ç' lloj teksti është?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

I dashuri Flamur,

Të dielën, më 3 shkurt, kam ditëlindjen.

Mbush 13 vjeç. Kam ftuar për të festuar ditëlindjen edhe shokët e shoqet e klasës.

Kam shumë dëshirë që të jesh edhe ti.

Të përqafoj,

Andi

a) *tregim*

b) *ftesë*

c) *fragment*

4. Shkruaj drejtë fjalët e dhëna:

Bicikletë, përinci, fjalorë, trupëmadh.

5. Numrat e dhënë shkruaj me fjalë:

3 _____

98 _____

2836 _____

1230 _____

6. Lexo fjalitë e dhëna më poshtë dhe duke e rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë trego se cila prej fjalive të dhëna është shkruar sipas rregullave drejtshkrimore?

a) Sportistat e vendit tanë stërviten shumë.

b) Shkolla duket si zgjua bletësh.

c) Sa më pëlqen të flituroj me aeroplan në qiellin e kaltërt.

7. Bashkëtingëlloret e poshtëshënuara *r, rr* janë:

a) *Hundore*

b) *Grykore*

c) *Dridhëse*

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

8. Shkruaj *antonimet* për fjalët e shënuara më poshtë:

Vij _____

kujtoj _____

keq _____

afër _____

mbrapa _____

9. Në fjalinë e poshtëshënuar nënvizo përemrin vetor:

Çdo mëngjesë ne shkojmë së bashku në shkollë.

10. Në fjalinë e poshtshënuar, si quhen këto tri (3) pika që janë përdorur në këtë fjali?

S'më duket dhe kaq...sot sa t'u bien në qafë arrëzat...

- a) Pikat e heshtjes
- b) Përfundim i fjalisë
- c) Fjalja e pakuptimtë.

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

11. Lexo me kujdes fjalinë e poshtshënuar dhe nënvizo shprehjen frazeologjike:

Vetëm në atë çast m'u zgjidh gjuha dhe bëra të flas, por tashmë ishte shumë vonë.

12. Në vend të pikave vini lidhëzat e duhura:

*Një mbrëmje një nuse që _____ ishte martuar në këto fshatra, mbushi ujë e fundit në këtë
çezme _____ harroi _____ ta mbyllte, _____ për gjithë natën rrodhi shumë ujë,
_____ e mbushi fushëgropën plotë me ujë.*

13. Në vend të pikave vini ndajfoljet e duhura:

Kur fëmijët zbresin _____, gjenden buzë liqenit, ndërsa kur marrin rrugën _____ arrin deri te një dru i madh. Një ditë fëmijët dolën _____ që të luanin.

14. Ndaj fjalët në rrokje:

Punëtori _____

Dora _____

Dera _____

Këpucët _____

15. Lexo vargjet e mëposhtme dhe duke rrethuar shkronjën përpara përgjigjes së saktë trego cilit lloj të poezisë i përkasin?

*Ka filluar të plaket nëna.
Fytyra e saj po mbulohet me rrudha.
Po mbulohet me një pleqëri të bukur.
Çështë kështu moj rrjetë që hedh koha mbi nënën time?
Dhe duart që më mbanin mua , tani janë rënduar.
Po s'ka gjë. Nga shpirti i saj
Zgjaten duart tjera që më mbajnë pezull.*

Qarko përgjigjen e saktë.

- a) Epike;
- b) Popullore;
- c) Lirike (portretizimit).

16. Lexo me vëmendje vargjet e shënuara dhe trego se ç'janë.

*Vrap e vrap e të Dhoqina.
-Mirë se erdhe, im vëlla!
Në ke ardhë për të mirë,
të vishem si gjeraqinë;
në ke ardhë për të keq,
të vishem si kallogjer.
- Jo, motër, sikundërje!
E hipi në vithe të kalit.
Zogjtë udhës thoshin:
„Cili-viu, ciu-viu,
kush ia bën, ai bën vetiu!
Kini parë e s'kini parë?
Shkon një bishtbardhë,
I vdekuri me të gjallë!”*

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë:

- a) letërsi e shkruar
- b) letërsi gojore
- c) letërsi artistike



17. Lexo vargjet e dhëna dhe trego llojin e letërsisë.

Kënga e Beratit

*E, ndërsa ne po mendonim
 Që ne varret t'i mbulonim,
 Përtej urës një vajzë
 Na u dëftua si një hije.
 Flok't i kishte ndërliksur,
 Syt' të futur thell' në ballë,
 Me fustanin copë-copë
 E me këmbë të përgjakura:
 „ O ushtarë, o vëllezër,
 Ju përher' të lumë qofshi!
 Mbase pat' në këtë fushë
 Një kalorës trim të ri
 Më një korkall-o të artë,
 Më një tuf' flokësh të verdhë.
 E ka ballin porsi dielli.
 Ka dy sy si dy shkëndija,
 Dy shkëndija të shkreptimës;
 E ka gojën si unazë.
 Edhe fjalëzën të ëmbël,
 Porsi hojet e pranverës
 Deh, ju lutem, me kallëzoni!”
 Sy ndër sy ne u vërejtëm.*

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

a) *letërsi gojore*

b) *letërsi e shkruar*



18. Lexo me vëmendje vargjet e shënuara dhe trego llojin e gjinisë letrare.

*Ka nisë provën e provë po ban:
I ka mbledhë nantë gjarpna t'shullanit,
Në gjoks gjarpnat trimi i ka vue,
Sa fort gjarpnat e kanë qokatë,
sa i gjallë kish qenq për t'gjallë s'u ndie!
I ka ndezë dy zjarre të mëdhenj
E ndërmjet Osmanin po na shtjen,
Para e mbrapa lëkura m'i pëlçet,
Gjallë kish' qenë , për t'gjallë s'u ndie!
Aspak besë krali s'i ka zanë.
M'i ka marrë njëzet maja gozhdash,
për nën thoj thellë ia ka shtie,
derisa gjaku trimit m'i ka dalë
Gjallë kish qenë, për të gjallë s'u ndie!
Aspak besë krali s'i ka zanë.*

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

- a) epikës
- b) lirikës
- c) dramatikës

19. Lexo vargjet e mëposhtme. Trego llojin e këngëve që u takon.

*Flej, o djalë, ti fletsh i bardhë
E gjithkund t'u dhashtë mbarë!
Ma gëzofsh emrin që ta kam ngjitë.
Mori mollë, ma gëzofsh të ritë!
Lumja nana, bir që të ka.*

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

- a) Këngë kreshnike
- b) Këngë legjendare
- c) Këngë djepi

20. A njihet autori në letërsinë e shkruar?

Rretho shkronjën përparapërgjigjes së saktë:

- a) *nuk njihet*
- b) *del me emër tjetër*
- c) *njihet*